



RREGULLORE PËR PUNËN E KOMISIONIT PËR ANKESA



Në bazë të pikës 6.5 të Statutit të Federatës së Sportit Shkollor, Bordi i FSSHRK-së, në mbledhjen e mbajtur më 13.10.2022, mori vendim për miratimin e rregullores së Këshillit Profesional për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta:

RREGULLORE PËR PUNËN E KOMISIONIT PËR ANKESA

Dispozitat themelore

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së Komisionit.

Neni 2

Përbërja, kompetencat dhe fusha e veprimit të komisionit rregullohen me Statutin e FSSHRK-së.

Neni 3

Anëtarë i Komisionit mundë të zgjidhet personi i cili njëherit është edhe anëtarë i Bordit, si dhe që ka fituar votat e shumicës së anëtareve të Bordit 50+1%.

Neni 4

Mandati i Anëtarit të Komisionit zgjatë dy vjet, prej momentit të emrimit të ti nga Bordi.



FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR

Neni 5

Anëtari i Komisionit në fushë veprimin e vetë kryen keto punë:

- Anëtari i Komisionit kryen të gjitha vërejtjet që mundë të vijn nga klubet apo shoqatat për ndonje parregullësi eventuale në ndonje ndeshje sportive.
- Anëtarët e Komisionit janë të obliguar që një afat prej 7-shtatë ditësh ti përgjigjen parashtrusit të ankesës, në të kundërt në qoftë se nuk veprohet mbas kesaj rregullore ata mbajn përgjegjësi për këtë veprim.
- Pas afatit të paraparë të përgjegjësis nga Komisioni, ankesa i kalon Komisionit të shkallës së dytë për shqyrtim.
- Anëtarët e Komisionit duhe të punojn pa presione, dhe ti respektojn vendimet e statutit të Federatës së Sportit Shkollor si dhe rregullat që janë në fuqi të hartura nga Bordi i saj.

Neni 6

Anëtarët e Komisionit për punën e vetë i përgjigjen Bordit dhe për mos funksionalitet.

MËNYRA E VENDOSJES

Neni 7

Votimi në mbledhje është i hapur. Anëtari i Komisionit duhet të votojnë “PËR”, pastaj “KUNDËR” Së pari thirrën të votojnë ata që janë “PËR”, pas tyre ata që janë “KUNDËR”.

Neni 8

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit të saj.

Neni 9

Interpretimin e kësaj Rregulloreje e bënë Bordi i FSSHRK.

Prishtinë

13.10.2022

Kryetari i FSSHRK-së

Adrian TELAKU prof.



FEDERATA E SPORTIT SHKOLLOR